



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçante



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401304/6

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Rekomandim për kryerjen e disa veprimeve ligjore për të mundësuar ekzekutimin e vendimit gjyqësor Nr. 4754, datë 25.06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Drejtuar : Z. Rrok G. DEDA
Zyra Përmbartimore "Andani Bailiff Office"
Rr. "S. Delvina", Nd. 51, H.9, Ap.1, pranë Hotel "Diplomat"

Tiranë

I nderuar Z. Deda,

Sikurse ju kemi vënë në dijeni, në institucionin tonë ka bërë ankesë shtetësja V.Sh.. Ankuesja shkruan se me vendimin Nr. 4754, datë 25.06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur, *detyrimi i të paditurit Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve Bashkia Tiranë, të dëmshpërblejë paditësen V.Sh. me pagën e një viti për shkak të zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të marrëdhënieve të punës, dy paga mujore për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, tre paga mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit dhe katër paga mujore si shpërblim për vjetërsi në punë.* Bazuar në nenin 317, gërma "b" të Kodit të Procedurës Civile, vendimi është dhënë me ekzekutim të përkohshëm.

Meqënëse ky vendim ka marrë cilësinë e titullit ekzekutiv, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr. 4754 Akti, datë 25.07.2013 është lëshuar urdhri i ekzekutimit të tij.

Znj. Sh. i është drejtuar zyrës tuaj me kërkesën e datës 01.08.2013 për ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor. Sipas ankueses, nga zyra juaj është bërë vetëm një shkresë, urdhër për shlyerje detyrimi nga personi i tretë në datën 03.10.2013 drejtuar shoqërisë "JJS" shpk dhe për dijeni palës debitorë. Ankuesja pretendon se, vendimi gjyqësor nuk është ekzekutuar akoma nga debitori dhe as nga personi i tretë, sepse nga zyra juaj nuk janë ushtruar të gjitha kompetencat ligjore për vënien në ekzekutim të këtij vendimi.

Me shkresën Nr. K2/V16-2 Prot., datë 17.07.2014 ju kërkuam të dërgonit:

1. Shpjegime të hollësishme lidhur me veprimet që janë kryer nga ana e zyrës tuaj për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit Nr. 4754, datë 25.06.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Kopje të të gjitha akteve (dokumentave) që janë bërë nga zyra juaj lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi.

Ju me shkresën Nr. 675 prot., datë 24.07.2014 na informuat se, nga zyra juaj janë kryer të gjitha veprimet ligjore të parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile për ekzekutimin e titullit ekzekutiv. Në vijim të përgjigjes përshkruani disa nga veprimet e kryera. Së bashku me shpjegimet na keni dërguar edhe fotokopje të të gjitha akteve (dokumentave) që keni bërë lidhur me këtë çështje.

Nga shqyrtimi i ankesës, i shpjegimeve tuaja dhe i akteve që keni kryer për të ekzekutuar titullin ekzekutiv të cituar më sipër, konstatojmë se pretendimet e ankueses se, nga zyra juaj nuk janë kryer të gjitha veprimet ligjore për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimit gjyqësor në favor të saj janë të vërteta, sepse:

1. Nuk rezulton që t'i jeni drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë (16) me urdhër për vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë që mund të ketë debitori, sepse vetëm 10 fokopje të përgjigje të tyre na keni dërguar.

2. Nuk i jeni drejtuar ZVRPP Tiranë me urdhër për vendosjen e sekuestros konservative mbi pasuritë e paluajtshme që mund të ketë debitori.

3. Nuk i jeni drejtuar DRSHTRR Tiranë me urdhër për vendosjen e sekuestros konservative mbi automjetet që mund të ketë debitori.

4. Nuk i jeni drejtuar me shkresë për informacion QKR lidhur me aktivitetin dhe pasurinë që disponon debitori dhe statusin juridik të tij.

5. Nuk keni bërë verifikimin në vend (Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve Bashkia Tiranë) të pasurisë së luajtshme (automjete, pjesë këmbimi etj) që disponon debitori.

Për të bërë të mundur realizimin e të drejtës ligjore të ankueses, bazuar në pikën 3, të nenit, 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike“* dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit“*, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive“*,

REKOMANDOJMË:

Kryerjen sa më shpejtë të veprimeve ligjore të mëposhtme:

1. Nxjerjen dhe dërgimin e urdhrit për vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë që mund të ketë debitori edhe në 6 Banka të tjera të Nivelit të Dytë.

2. Nxjerjen dhe dërgimin e urdhrit ZVRPP Tiranë për vendosjen e sekuestros konservative mbi pasuritë e paluajtshme që mund të ketë debitori.

3. Nxjerjen dhe dërgimin e urdhrit DRSHTRR Tiranë për vendosjen e sekuestros konservative mbi pasuritë e luajtshme (automjeteve) të debitorit.

4. Kërkesë për informacion drejtuar QKR lidhur me aktivitetin dhe pasurinë që disponon debitori dhe statusin juridik të tij.

5. Verifikimin në vend (Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve Bashkia Tiranë) të pasurisë së luajtshme (automjete, pjesë këmbimi etj) që disponon debitori.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na vini në dijeni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R I

Arben SHKËMBI